

VENDIM
Nr. 221, datë 13.4.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 795, DATË 22.9.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK,
TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “UNAZA LINDORE TIRANË
(LOTET I, II)”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 795, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 3 bëhen këto ndryshime:

a) Në fjalinë e parë, vlera e shpronësimit “278 268 838 (dyqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e tetë) lekë” zëvendësohet me “293 549 545 (dyqind e nëntëdhjetë e tre milionë e pesëqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind e dyzet e pesë) lekë”.

b) Dy nënparagrafët, ku përcaktohen sipërfaqet e pasurive sipas llojeve dhe vlerat e tyre, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“- tokë “arë”, “truall” dhe “pyll”, me sipërfaqe 136 855.60 (njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë) m², me vlerë 64 211 333 (gjashtëdhjetë e katër milionë e dyqind e njëmbëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë;

- “objekte”, me vlerë 229 338 212 (dyqind e njëzet e nëntë milionë e treqind e tridhjetë e tetë mijë e dyqind e dymbëdhjetë) lekë.”.

2. Në pikën 4 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fjalinë e parë, vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë “arë”, “truall”, “pyll” dhe “objekte” prej “278 268 838 (dyqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e tetë) lekësh” zëvendësohet me “293 549 545 (dyqind e nëntëdhjetë e tre milionë e pesëqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind e dyzet e pesë) lekë”;

b) Në fund të pikës shtohet nënparagrafi, me këtë përmbajtje:

“- 15 280 707 (pesëmbëdhjetë milionë e dyqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatë) lekë të përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.”.

3. Tabelave bashkëlidhur vendimit në fuqi, të ndryshuar, i shtohet edhe tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

III. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË PRONË PRIVATE TË TË CILËVE PREKEN NGA DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 795, DATË 22.9.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “UNAZA LINDORE TIRANË (LOTET I, II)”, TË NDRYSHUAR

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. pas	Lloji pasurisë	Sipërfaqja totale (m ²)	Sipërfaqja e shpronësuar	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lekë)	Sip. ndërtimi (m ²)	Çmimi mes. sipas sh/blerjeve nga ASHK	Vlera totale (lek)	Adresa	Shënime
1	Bajram	Haxhi	Zhllima	1604	868/15	Arë	3,359.20	1,315	448	589,120			589,120	Nj. Administrative Farkë	Konfirmuar nga ASHK
2	Hasan	Musa	Qordja	3550	170/3	Truall	470	53	457	24,221			24,221	Nj. Administrative Farkë	Konfirmuar nga ASHK
3	Hasan	Musa	Qordja	3550	170/2	Arë	10,060	642	448	287,616			287,616	Nj. Administrative Farkë	Konfirmuar nga ASHK
4	Zenel	Hajdar	Balla	3550	165/9	Arë	3,400	1,225	230	28,175			281,750	Nj. Administrative Farkë	Konfirmuar nga ASHK (Miratuar me VKM nr. 795, datë 22.09.2015 me nr. Pasurie 165/9 për Arë 2175 m ²)
5	Ejup	Rexhep	Iskurti	3976	170/16-ND	Ndërtesë	106				212	66,500	14,098,000	Nj. Administrative Farkë	Konfirmuar nga ASHK
VLERA TOTALI							17,395.20	3,235		1,182,707	212	66,500	15,280,707		